

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zbokthi nuk është thjesht tharje e skalpit/ Ja pse shfaqet dhe si mund ta mbani nën kontroll
ADRESA	https://piranjat.al/lifestyle/zbokthi-nuk-eshte-thjesht-tharje-e-skalpit-ja-pse-shfaqet-dhe-si-mund--i104212
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 12:34:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 12:24:59 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5ede99691f7702c7d6affeff925fbc78b03aa7b4adc4d5cdb75f5a760d6b065b
TEKSTI	ad940058b1b0335023fe6215c573a2b3aa2b2d04e2aad59b7ead22749e5db29d
PAMJA	676b4575c0961fc0adc6f1a4d41dc2250e4e7be838e1056ac0490e6601620b57

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	675f536a592b499e0c12eb7e5d28e1b2c5e97e1f1f5d162e1bdcce7f86a830f1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7b60020d12239b3c3f63032b973e8451536e9d643adb77567035503a03c510f7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/675f536a592b499e0c12eb7e5d28e1b2c5e97e1f1f5d162e1bdcce7f86a830f1>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **41-vjeçari** kishte kultivuar bimë narkotike n... ■ **Luizim Caka** ishitej me dy identitete, duke... ■ **Ilir Metën** GKKO ka rrëzuar kërkesën e tij për... ■ **panda shqiptare** në... ■ **procedohen** arrestimin në flagranc&eum...

[LIFESTYLE](#)

Zbokthi nuk është thjesht tharje e skalpit/ Ja pse shfaqet dhe si mund ta mbani nën kontroll

Piranjat Përditësimi i fundit 15 Shtator 2026, 14:24



Nëse zbokthi të shfaqet vazhdimisht dhe luspave e bardha përfundojnë mbi rroba, problemi mund të mos jetë thjesht tharja e skalpit. Zbokthi është shumë i zakonshëm dhe mund të shkaktohet nga disa faktorë, ndërsa me kujdesin e duhur mund të mbahet nën kontroll.

Çfarë është në të vërtetë zbokthi?

Zbokthi lidhet me një reagim inflamator në skalp dhe me shtimin e tepërt të kërpudhës Malassezia, e cila gjendet normalisht në lëkurë. Kur kjo kërpudhë shtohet më shumë seç duhet, mund të shkaktojë kruajtje, irritim dhe shfaqjen e luspave.

Nuk ekziston një kurë përfundimtare për zbokthin, por trajtimet e duhura mund ta kontrollojnë atë dhe të mbajnë skalpin të shëndetshëm.

Pse shfaqet zbokthi?

Nuk ka një shkak të vetëm. Sasia e yndyrës së prodhuar nga lëkura, prania e Malassezia dhe mënyra se si skalpi reagon ndaj tyre luajnë rol në shfaqjen e zbokthit.

Gjendja mund të përqeshohet edhe nga faktorë të tjerë. Moti i ftohtë dhe i thatë, për shembull, mund të shkaktojë shpërthime, ndërsa edhe stresi mund ta përqeshojë problemin.

Zbokthi nuk shfaqet vetëm në skalp. Në disa raste mund të prekë edhe vetullat, veshët, pjesën qendrore të fytyrës, qepallat, pjesën e sipërme të krahavorit, shpinën, sqetullat dhe zona të tjera.

Zbokth apo skalp i thatë?

Këto dy gjendje shpesh ngatërrohen, por nuk janë e njëjta gjë. Zbokthi lidhet kryesisht me shtimin e tepërt të Malassezia-s dhe inflamacionin, ndërsa skalpi i thatë lidhet më shumë me mungesën e lagështisë.

Një mënyrë për t'i dalluar është pamja e luspave. Zbokthi zakonisht shkakton luspave më të trasha, më të yndyrshme dhe ndonjëherë me nuancë të verdhë. Në rastin e skalpit të thatë, ato janë zakonisht më të vogla dhe të bardha.

Edhe psoriaza dhe ekzema e skalpit mund të shkaktojnë kruajtje dhe luspave. Nëse problemi është i vazhdueshëm ose i rëndë, dermatologu mund të përcaktojë shkakun dhe trajtimin e duhur.

Cilët përbërës ndihmojnë kundër zbokthit?

Dermatologët rekomandojnë të kërkojnë shampo kundër zbokthit që përmbajnë përbërës aktivë si:

Sulfidi i selenit, i cili ka veprim kundër kërpudhave dhe mund të ulë kruajtjen dhe irritimin.

Piritonati i zinkut, me veti kundër mikrobeve dhe kërpudhave, që ndihmon edhe në qetësimin e inflamacionit.

Acidi salicilik, i cili ndihmon në largimin e luspave dhe kontrollin e yndyrës së tepërt.

Ketokonazoli, një përbërës kundër kërpudhave me veti të lehta anti-inflamatore.

Katrani i qymyrit, që mund të frenojë kërpudhat dhe të ulë inflamacionin.

Vaji i pemës së çajit, i cili ka veti antibakteriale, kundër kërpudhave dhe anti-inflamatore.

Si ta trajtosh zbokthin?

Një hap i parë është përdorimi i një shampoje kundër zbokthit, veçanërisht një formulë me acid salicilik, për të ndihmuar në largimin e luspave dhe kontrollin e simptomave.

Nëse shampoja nuk sjell përmirësim, është mirë të konsultohesh me dermatologun. Në raste të tilla mund të nevojiten shampo mjekësore ose trajtime që aplikohen drejtpërdrejt në skalp. Për disa persona mund të rekomandohen edhe trajtime me kortizon për të kontrolluar inflamacionin ose shampo me ketokonazol.

A duhet t'i lash flokët më shpesh?

Sipas dermatologëve, larja e përditshme mund të jetë në rregull për personat që kanë zbokth, sidomos kur përdoren produkte me përbërës aktivë që synojnë shkakun e problemit.

Megjithatë, nëse flokët janë të lyer ose nuk dëshiron t'i lash çdo ditë, ekzistojnë edhe trajtime të tjera për skalpin që mund të ndihmojnë në zgjatjen e efektit të larjes.

A ndihmojnë serumet për skalpin?

Po. Serumet e krijuara për skalpin mund të jenë të dobishme, veçanërisht ato që përmbajnë acid salicilik ose vaj të pemës së çajit. Nëse zbokthi shoqërohet me kruajtje, përbërës qetësues dhe hidratues mund të ndihmojnë në qetësimin e skalpit.

Çfarë duhet të shmangësh?

Disa zakone mund ta përkeqësojnë zbokthin. Dermatologët këshillojnë të shmangësh përdorimin e tepërt të shamos së thatë, pasi mund të krijojë grumbullime në skalp.

Po aq e rëndësishme është të mos kruash apo shkulësh lusat. Kjo mund të rrisë inflamacionin, të dëmtojë barrierën mbrojtëse të lëkurës dhe madje të shkaktojë infeksione dytësore.

Edhe trajtimet e shpeshta kimike, zbardhimi agresiv i flokëve, stilimi i tepërt dhe disa trajtime të rënda me vajra mund ta irritojnë skalpin dhe të shkaktojnë përkeqësim.

Po trajtimet në shtëpi?

Vaji i kokosit mund të ndihmojë në hidratimin e flokëve dhe skalpit, por nuk është zgjedhja më e mirë për të gjithë. Te personat me skalp të yndyrshëm mund të bllokojë poret dhe, në disa raste, ta përkeqësojë problemin.

Edhe uthulla e mollës përdoret nga disa persona për kujdesin e skalpit, pasi aciditeti i saj mund të ndihmojë në ruajtjen e ekuilibrit të pH-it dhe në largimin e mbetjeve. Megjithatë, këto metoda nuk zëvendësojnë trajtimin mjekësor kur zbokthi është i vazhdueshëm ose i rëndë.

A mund të largohet përgjithmonë zbokthi?

Jo domosdoshmërisht. Meqë zbokthi lidhet me mikroorganizmat që jetojnë natyrshëm në lëkurën tonë, ai mund të rikthehet. Megjithatë, shampoja e duhur, kujdesi i rregullt dhe trajtimi sipas nevojës mund ta mbajnë nën kontroll.

Nëse zbokthi nuk përmirësohet, është shumë e theksuar, shoqërohet me skuqe, plagë ose kruajtje të fortë, konsultimi me dermatologun është zgjedhja më e mirë për të përcaktuar nëse bëhet fjalë për zbokth apo për një gjendje tjetër të skalpit.

Artikuj te sugjeruar

LIFESTYLE 15 Shtator11:50

[Zbulohet “mega-Toka” misterioze, planeti 23.5 herë më masiv se Toka që sfidon shkencëtarët](#)

Astronomët kanë zbuluar një ekzoplanet jashtëzakonisht të pazakontë, GJ 523b, me një masë rreth 23,5 herë më...

Piranjart News LIFESTYLE 15 Shtator08:50

[Pse nuk e harron kurrë shkollën e mesme?](#)

Kodet enigmatike të kulturës adoleshente mund të ndikojnë thellësisht në pjesën tjetër të jetës sonë. P...

LIFESTYLE 15 Shtator06:27

[Çfarë ju pret sot? Mësoni parashikimin e 12 shenjave të Horoskopit](#)

Dashi Do jeni mjaft sensuale gjate gjithë kësaj dite dhe partneri do ju dashuroje me më shumë pasion. Do kaloni çaste te mrekullueshme ...

LIFESTYLE 14 Shtator23:35

[VIDEO/ Aventura e turistit në jahtin luksoz shkon si mos më keq!](#)

Ky është momenti tronditës kur një turist skocez “i çmendur” përfundon në ujë, pasi një aventurë...

LIFESTYLE 14 Shtator22:02

["Data 18 do të jetë e vështirë"/ Astrologia Meri Shehu paralajmëron shenjat, ja çfarë pritet të ndodhë këtë javë](#)

Është një javë interesante, bën të ditur astrologia Meri Shehu duke theksuar se edhe pse sot ishte një ditë me zgjidhje ...

LIFESTYLE 14 Shtator21:55

[Distanca më e madhe e një gjitari/ Ja sa udhëtojnë qentë afrikanë për të gjetur një partner](#)

Një tufë qensh të egër afrikanë ka përfunduar një udhëtim rekord prej 2,485 miljesh (rreth 4,000 kilometra) përmes ...

LIFESTYLE 14 Shtator20:19

[Ozempic, Wegovy dhe Mounjaro/ 13 të vërteta dhe mite për ilaçet që po përdoren për dobësim](#)

Ilaçet me injeksion për dobësim janë kthyer në një nga temat më të diskutuara të viteve të fundit. Ozempic, ...

LIFESTYLE 14 Shtator16:52

[Çantat, emocionet dhe fotot e para/ Xhensila, Ledri e Sara Hoxha tregojnë ditën e parë të shkollës së fëmijëve](#)

14 shtatori ka rikthyer emocionet e ditës së parë të shkollës, edhe për familjet e personazheve të njohur të showbizit...

Piranjat News LIFESTYLE 14 Shtator11:58

[VIDEO/ Fshatarët lidhin teknikun me kablo në një antenë celulare sepse nuk kishin 5G të mirë](#)

Një incident i pazakontë ka ndodhur në një fshat në Indi, ku banorët, të zemëruar nga mbulimi i dobët 5G, th...

LIFESTYLE 14 Shtator06:59

[Horoskopi/ Njihuni me parashikimin e yjeve për secilën shenjë](#)

Dashi Natyra juaj nuk do t'ju lërë në asnjë moment të bini pre e pesizmit, nuk do të thotë se si do të përballemi....

ME TE VIZITUARAT

POLITIKE 14 Shtator

[FOTO- 'Mos u kthe më në Shqipëri'/ Edi Rama sul...](#)

Edi Rama ka sulmuar me thonj dhe ka kërcënuar një emigrant shqiptar në Napoli duke iu drejtuar me fjalët: Të zhduk. Gazetari &C...

AKTUALITET 14 Shtator

[EMRAT/ Fermë droge prej 4.5 milionë paund në kl...](#)

Një shtetas shqiptar është dënuar me burg për rolin e tij si kultivues në një fermë kanabisi me vlerë 4.5 milion&eu...

BOTA 14 Shtator


["E drog*va dhe abuz*va gruan për 20 vite"/ Bash...](#)

Një burrë britanik pranoi sot se kishte droguar dhe përdhunuar gruan e tij në shtëpinë e tyre për rreth dy dekada. Burri, ban...


INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...


video

Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV



Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.